



UBT
Fakuteti Gjuhë Angleze

PLANI VJETOR I MONITORIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E CILËSISË

Viti Akaemik: 2025-2026

Shtator, 2025

Bazuar në Raportin Vjetor të Cilësisë për vitin 2024–2025, është hartuar Plani i Monitorimit për Përmirësimin e Cilësisë për vitin akademik 2025–2026. Ky plan përcakton veprime konkrete, afate kohore, aktorë përgjegjës dhe indikatorë të performancës për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm dhe zbatim efektiv të rekomandimeve, në përputhje me standardet e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AAK) dhe politikat e sigurimit të cilësisë të UBT-së.

FUSHAT PËR PËRMIRËSIM	VEPRIMET E NEVOJSHME VJETORE	AFATI KOHOR	PERSONAT PËRGJEGJËS	INDIKATORËT E PERFORMANCËS	PËRFUNDIMI I AKTIVITETIT
Harmonizimi konstruktiv i rezultateve të të nxënit të lëndëve me aktivitetin mësimor dhe vlerësimin e studentëve	Përmirësimi i organizimit të trajnimeve	Tetor 2025, përgatitje për semestrin dimëror të vitit akademik 2025–2026	Stafi i Fakultetit të Gjuhës Angleze	Përditësimi i syllabuseve sipas këtij objekti para fillimit të semestrit dimëror 2025–2026	Përditësimi i syllabuseve sipas këtij objekti për Fakultetin e Gjuhës Angleze
Standardet udhëzuese për studentët dhe mësimdhënësit e Fakultetit të Gjuhës Angleze	Forcimi i bashkëpunimit me industrinë	Janar 2026	Stafi menaxhues i Fakultetit të Gjuhës Angleze në bashkëpunim me Nënkomisionin për Sigurim të Cilësisë	Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit dhe informimit të profesorëve dhe studentëve lidhur me përgjegjësitë e tyre akademike	Udhëzime të përditësuara të publikuara online dhe të qasshme për të gjithë studentët dhe stafin në gjuhën shqipe dhe angleze
Zhvillimi i mekanizmave të monitorimit	Rishikim sistematik i syllabuseve	Janar 2026	Këshilli i Fakultetit në bashkëpunim me Nënkomisionin për Sigurim të Cilësisë	Matje periodike e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit	Vendosja dhe zbatimi i metodave dhe mjeteve të planifikuara të monitorimit
Rritja e nivelit të diplomimit të studentëve	Përditësimi i udhëzimeve dhe politikave për studentët dhe profesorët	Pril 2026	Nënkomisioni për Temat e Diplomës në bashkëpunim me Nënkomisionin për Sigurim të Cilësisë	Përcaktimi i një plani konkret raportimi periodik për studentët që nuk respektojnë afatet akademike	Rritja e numrit të studentëve që përfundojnë studimet dhe diplomohen
Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore akademike	Zhvillimi i indikatorëve dhe mjeteve të monitorimit	Nëntor 2026	Nënkomisioni Shkencor në bashkëpunim me Nënkomisionin	Rritja e ndërgjegjësimit të studentëve për specializimet ose	Rritja e numrit të publikimeve të profesorëve në bashkëpunim me



			për Sigurim të Cilësisë	interesat e tyre të ardhshme dhe motivimi për përfshirje në projekte kërkimore sipas fushave të interesit	studentët
Zhvillimi i intervistave gjysmë- të strukturuar për identifikimin e arsyeve të dështimeve të shpeshta në provime	Mbledhje dhe analizë sistematike e të dhënave	Nëntor 2026	Nënkomisioni Shkencor në bashkëpunim me Nënkomisionin për Sigurim të Cilësisë	Monitorim periodik i suksesit të studentëve në provime	Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në konferencat vjetore UBT – ICED dhe ICLAC

Personat përgjegjës:

Dekane: Dr. Alma Lama

Koordinatorë e Fakultetit: MA Adea Haxhiavdyli

Nënkomisioni për Sigurim të Cilësisë:

- Dr. Fatbardha Qehaja Osmani
- PhDc Rina Sefiu
- MA Adea Haxhiavdyli
- **Studente:** Era Deva
- **Alumni:** Eljesa Ismajli

Ky plan monitorimi do të zbatohet duke filluar nga shtatori 2025 dhe do të rishikohet gjatë gjithë vitit akademik. Ndryshimet do të bëhen bazuar në reagimet e vazhdueshme dhe në arritjen e indikatorëve të përcaktuar të performancës.